



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM
Nr. 26 datë 29.4.2024**

“PËR MIRATIMIN E DHËNIES NË PËRDORIM ME KONTRATË QIRAJE TË EKONOMISË PYJORE “LUGINA E KIRIT”, NJËSIA ADMINISTRATIVE PULT, NGA STRA 189b, ME SIPËRFAQE 250 M², ME AFAT 5-VJEÇAR, PËR VENDOSJEN E ANTENAVE TË KOMUNKIMIT TË KOMPANISË TË TELEFONISË CELULARE “ONE ALBANIA SH.A”

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 29.4.2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur nenin 9 pika 1.2 shkronja ‘c’, nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja ‘e/l’ të ligjit nr.139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; Ligjit nr.57/2020 “Për pyjet”; VKM nr.433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish- komunave/bashkive”. të ndryshuar; VKM nr 559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike dhe prodhimet drusore e jodrusore pyjore, si dhe mënyrën e procedurën e mbledhjes së tyre” i ndryshuar; Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit nr.1 datë 9.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik”

V E N D O S I:

1. Të miratojë dhënie në përdorim me kontratë qiraje të ekonomisë pyjore/kullosore “Lugina e Kirit”, Njësia Administrative Pult, nga str. 189/b(189b1+189b2), me sipërfaqe 250 m², me afat 5-vjeçar, për vendosjen e antenave të komunikimit të kompanisë të Telefonisë Celulare “ONE Albania” sh.a.
2. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

KRYETAR

Oltion LULLI



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Denis Lesha

Miratur me 34 vota
Vota Pro 34
Vota Kunder 1
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 2.5.2024